**VENDIM**
**Nr. 389, datë 28.5.2026**

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "BAZA AJRORE FARKË", ME VENDNDODHJE NË BASHKINË TIRANË, ME SUBJEKT ZHVILLUES MINISTRINË E MBROJTJES**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Baza Ajrore Farkë", me vendndodhje në Bashkinë Tiranë, me subjekt zhvillues Ministrinë e Mbrojtjes.
2. Shpronësimi bëhet në favor të Komandës së Forcës Ajrore, Ministria e Mbrojtjes.
3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit "arë" dhe "dru frutorë", me një vlerë të përgjithshme prej 18 396 117 (tetëmbëdhjetë milionë e treqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e njëqind e shtatëmbëdhjetë) lekësh.
4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 18 396 117 (tetëmbëdhjetë milionë e treqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e njëqind e shtatëmbëdhjetë) lekësh, përballohet nga buxheti i Komandës së Forcës Ajrore, Ministria e Mbrojtjes.
5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga buxheti i Komandës së Forcës Ajrore, Ministria e Mbrojtjes.
6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.
7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Komandës së Forcës Ajrore, Ministria e Mbrojtjes.
8. Komanda e Forcës Ajrore, Ministria e Mbrojtjes, kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.
9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Komanda e Forcës Ajrore, Ministria e Mbrojtjes.
10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tirana Rurale 1, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë në favor të shtetit, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes, për Komandën e Forcës Ajrore, për pasuritë e shpronësuara, sipas këtij vendimi.
11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë në favor të shtetit, në përgjegjësi administrimi të

Ministrisë së Mbrojtjes, për Komandën e Forcës Ajrore, për pasuritë e shpronësuara, sipas këtij vendimi.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Mbrojtjes, Komanda e Forcës Ajrore, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tirana Rurale 1, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin dhe Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

LISTA EMËRORE E PRONARËVE, PASURITË E PALUAJTSHME, PRONË PRIVATË TË TË CILËVE SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK, PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT “BAZA AJRORE FARKË”, ME VENDNDODHJE NË BASHKINË TIRANË, ME SUBJEKT ZHVILLUES MINISTRINË E MBROJTJES

| Nr. | PRONARI | | | TË DHËNAT KADASTRALE (SIPAS KARTELËS SË PASURISË) | | | | | | | | | | VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM | | | | | | SHËNIME (kufizime hipotekare, barrë mbi pasurinë etj.) |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | | | | | | | ARË | | | Vlerat e kulturave bujqësore dhe dru-frutorëve sipas procesverbalit të Drejtorisë së Bujqësisë | | VLERA TOTALE (lekë) | |
| | Emri | Atësia | Mbiemri | Fshati ose qyteti | Z. kadastrale | Nr. i pasurisë | Lloji i pasurisë | Sipërfaqja totale | Arë (m²) | Truall (m²) | Ndërtesë (m²) | Volumi | Faqe | Sipërfaqja (m²) | Çmimi (lekë/m²) | Vlera (lekë) | Vlera e kulturës bujqësore (lekë) | Vlera e dru-frutorëve (lekë) | | |
| 1 | Shaqir | Kasem | Kadiu | Tiranë | 3550 | 226/1 | ARE | 7620 | 7620 | | | 3 | 133 | 3,528 | 448 | 1,580,544 | | 315,730 | 1,896,274 | |
| 2 | Ramiz | Tahir | Balla | Tiranë | 3550 | 225/6 | ARE | 2220 | 2220 | | | 5 | 138 | 529 | 448 | 236,992 | | | 236,992 | |
| 3 | Naile | Hasa | Ymer (Balla) | Tiranë | 3550 | 225/9 | ARE | 2870 | 2870 | | | 6 | 188 | 684 | 448 | 306,432 | | | 306,432 | |
| | Lindita | Ymer | Cema (Balla) | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| | Bedri | Ymer | Balla | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 4 | Baftjar | Jemin | Isufi | Tiranë | 3550 | 225/2 | ARE | 4630 | 4630 | | | 1 | 173 | 1,610 | 448 | 721,280 | | 25,600 | 746,880 | |
| 5 | Hysni | Fadil | Cullhaj | Tiranë | 3550 | 204/3 | ARE | 750 | 750 | | | 10 | 203 | 750 | 448 | 336,000 | | | 336,000 | |
| 6 | Kujtim | Fadil | Cullhaj | Tiranë | 3550 | 204/4 | ARE | 375 | 375 | | | 10 | 204 | 375 | 448 | 168,000 | | | 168,000 | |
| 7 | Sali | Fadil | Cullhaj | Tiranë | 3550 | 204/5 | ARE | 375 | 375 | | | 10 | 205 | 375 | 448 | 168,000 | | | 168,000 | |
| 8 | Vjollca | Ilo | Papa | Tiranë | 3550 | 206/3 | ARE | 1646 | 1646 | | | 7 | 94 | 1,646 | 448 | 737,408 | | | 737,408 | |
| 9 | Agim | | Husha | Tiranë | 3550 | 206/4 | ARE | 1646 | 1646 | | | 7 | 95 | 1,646 | 448 | 737,408 | | | 737,408 | |
| | Agron | | Husha | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| | Enver | | Husha | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| | Lirie | | Husha | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| | Myzejen | | Alla | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| | Sadete | | Lala | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| | Vjollca | | Qordja | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 10 | File | Osman | Myrta | Tiranë | 3550 | 206/5 | ARE | 1646 | 1646 | | | 7 | 96 | 1,646 | 448 | 737,408 | | | 737,408 | |
| | Shkelqim | Qamil | Cullhaj | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| | Nazmi | Qamil | Cullhaj | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| | Lirie | Qamil | Bleta | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| | Hatixhe | Qamil | Bleta | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| | Fije | | Cullhaj | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 11 | Shaban | Qazim | Nexhi | Tiranë | 3550 | 206/6 | ARE | 1646 | 1646 | | | 7 | 97 | 1,646 | 448 | 737,408 | | 329,835 | 1,067,243 | |
| 12 | Altin | | Cullhaj | Tiranë | 3550 | 206/8 | ARE | 1646 | 1646 | | | 7 | 99 | 1,646 | 448 | 737,408 | | | 737,408 | |
| | Saimir | | Cullhaj | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| | Vjollca | | Cullhaj | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| | Manjola | | Peposhi | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 13 | Albana | Bajram | Masha | Tiranë | 3550 | 206/9 | ARE | 1646 | 1646 | | | 7 | 100 | 1,646 | 448 | 737,408 | | | 737,408 | |
| 14 | Basri | Mexhit | Hakcani | Tiranë | 3550 | 206/10 | ARE | 1646 | 1646 | | | 7 | 101 | 1,646 | 448 | 737,408 | | | 737,408 | |
| | Erinda | Festim | Hakcani | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| | Algert | Festim | Bakërri | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| | Malvina | Agim | Bakërri | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| | Apostol | Festim | Borita | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 15 | Astrit | Xhafer | Myrto | Tiranë | 3550 | 206/11 | ARE | 1646 | 1646 | | | 7 | 102 | 1,646 | 448 | 737,408 | | | 737,408 | |
| | Bedri | Xhafer | Myrto | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| | Edmond | Xhafer | Myrto | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| | Kujtim | Xhafer | Myrto | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| | Leonard | Xhafer | Myrto | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| | Ylli | Xhafer | Myrto | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| | Merita | Xhaferr | Lica | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 16 | Fatbardha | Qerim | Liçi | Tiranë | 3550 | 206/12 | ARE | 1646 | 1646 | | | 7 | 103 | 1,646 | 448 | 737,408 | | | 737,408 | |
| | Gani | Qerim | Isufi | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| | Shpresa | Qerim | Hida | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| | Demir | Qerim | Isufi | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| | Ornela | Naim | Isufi | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| | Ilirjan | Naim | Isufi | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| | Sanije | Zenel | Isufi | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| | Muharrem | Qerim | Isufi | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| | Lutfi | Qerim | Isufi | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| | Isa | Serjan | Braha | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| | Andrula | Isa | Braha | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| | Sindiana | Isa | Braha | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 17 | Mimoza | Jonuz | Caveli | Tiranë | 3550 | 206/13 | ARE | 1000 | 1000 | | | 7 | 104 | 1,000 | 448 | 448,000 | | | 448,000 | Konfirmuar nga DVASHK Rurale 1, datë 20.10.2025,<br>- Me nr. regjistrimi 0001089, datë 9.2.2017,. Bllokohet në favor të shoq. “NEWCRED” për shumën 2.600.000.<br>- Me nr. regjistri 1931, datë 9.12.2021. Lloji i kufizimit: “Hipotekë ligjore e kredisë së dhënë nga institucionet bankare”, me emërtim “Kontratë/deklaratë noteriale për vendosje hipoteke”, datë 25.11.2021, afatin i kufizimit 7 vjet.<br>- Me nr. regjistri |

| | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | 00001931, datë 9.12.2021, “Pasuria bllokohet në favor të “UNIFIN” për vlerën 22000 euro, kontratë hipotekare nr. 2939/1298, rep./kol. datë 25.11.2021. |
| 18 | Klodian | Muhamet | Maqellara | Tiranë | 3550 | 206/14 | ARE | 329.2 | 329.2 | | | 10 | 132 | 329 | 448 | 147,482 | | 65,956 | 213,438 | |
| 19 | Faik | Muhamed | Maqellara | Tiranë | 3550 | 206/15 | ARE | 329.2 | 329.2 | | | 10 | 133 | 329 | 448 | 147,482 | | 65,956 | 213,438 | |
| 20 | Mimoza | Muhamet | Zelaj | Tiranë | 3550 | 206/16 | ARE | 329.2 | 329.2 | | | 10 | 134 | 329 | 448 | 147,482 | | 65,956 | 213,438 | |
| 21 | Raimonda | Muhamet | Çaushllari | Tiranë | 3550 | 206/17 | ARE | 329.2 | 329.2 | | | 10 | 135 | 329 | 448 | 147,482 | | 65,956 | 213,438 | |
| 22 | Liliana | Muhamet | Maqellara | Tiranë | 3550 | 206/18 | ARE | 329.2 | 329.2 | | | 10 | 136 | 329 | 448 | 147,482 | | 65,956 | 213,438 | |
| 23 | Haki | Sulejman | Plaku | Tiranë | 1604 | 58/14 | ARE | 1867 | 1867 | | | 13 | 113 | 406 | 448 | 181,888 | | | 181,888 | |
| 24 | Xhemile | Ali | Manaj | Tiranë | 1604 | 68/11 | ARE | 1150 | 1150 | | | 10 | 243 | 1,050 | 448 | 470,400 | | 14,700 | 485,100 | |
| | Zyber | Mehmet | Manaj | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| | Sokol | Mehmet | Manaj | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| | Emin | Mehmet | Manaj | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| | Mustaf | Mehmet | Manaj | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| | Kreshnik | Mehmet | Manaj | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 25 | Gëzim | Hajdar | Duraku | Tiranë | 1604 | 68/12 | ARE | 2000 | 2000 | | | 10 | 244 | 1,437 | 448 | 643,776 | | 12,200 | 655,976 | |
| 26 | Haxhi | Zenel | Dina | Tiranë | 1604 | 68/3 | ARE | 6700 | 6700 | | | 1 | 213 | 6,700 | 448 | 3,001,600 | | 29,920 | 3,031,520 | |
| 27 | Lulzim | Sefer | Dina | Tiranë | 1604 | 68/14 | ARE | 3685 | 3685 | | | 12 | 246 | 3,685 | 448 | 1,650,880 | | 50,480 | 1,701,360 | Konfirmuar nga DVASHK Rurale 1, datë 20.10.2025. - Me nr. regjistri 3477, datë 4.3.2024, lloji i kufizimit “Garanci hipotekare/bllokim në favor të të tretëve”, kontratë e shitjes, këmbimit ose dhurimit me rezervë/kusht të pasurisë së paluajtshme nr. 1387/617, datë 23.2.2024, afati i kufizimit 15 vjet. |
| | **VLERA TOTALE** | | | | | | | | | | | | | | | 17,287,872 | | 1,108,245 | **18,396,117** | |